



Marrëveshje Bashkëpunimi

Ndërmjet:

Universitetit Barleti

dhe

BoldCest

duke mbajtur parasysh se:

- *Institucionet e Arsimit të Lartë janë qendra kryesore të kërkimit shkencor kombëtar dhe është detyrë e tyre të përpunojnë e të përçojnë në mënyrë krijuese njohuritë shkencore;*
- *është në interes të IAL-ve të vendosin një raport të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor;*
- *palët synojnë shkëmbimin e dijeve dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta përmes leksioneve të hapura, seminareve, trajnimit në laborator dhe praktikave;*
- *palët synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përbashkët kooperimi që do të promovojë specialistë të mirëfilltë.*

Palët bien dakord të bashkëpunojnë, për krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë në kuadër të programeve të Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit dhe Departamentit të Industrive Kreative si pjesë të Faktultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative.



Neni 1 Qëllimi dhe Objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e përgjithshme të palëve, drejt realizimit në një moment të dytë të marrëveshjeve specifike lidhur me fushat e bashkëpunimit e shkëmbimit të listuara në pikën 2 të këtij neni. Në marrëveshjet specifike do të detajohet lloji i aktiviteteve të përbashkët, si dhe çdo detyrim financiar midis palëve.

2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:

- a. Shkëmbim të stafit akademik dhe/ose specialistëve;
- b. Praktika mësimore në kuadër të procesit akademik dhe specializime;
- c. Ofrimin e mundësive të punësimit për studentët më të mirë;
- d. Aplikimin e përbashkët në projekte dhe programe të ndryshme bashkëpunimi;
- e. Organizimi i seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme shkencore;
- f. Përdorimin e ambienteve respektivisht për praktika, laboratore, seminare, konferenca etj;
- g. Promovimi i palëve në kuadër të aktiviteteve të secilit partner.

Neni 2 Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 4 vjet nga data e firmosjes.

2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje rinovohet për një afat tjetër 4-vjeçar.

Neni 3 Informacion mbi palët

1. *Universiteti BARLETI* (në vijim Barleti) është një universitet privat, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun ndërkombëtar. Misioni i Univeristetit është krijimi i një institucioni akademik elitare, bazuar në praktikën e vlerat më të mira



ndërkombëtare, më programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

2. *BoldCrest u themelua në vitin 2019 nga një grup të rinjsh të apasionuar pas design dhe marketing. Gjatë viteve, BoldCrest synon të ofrojë një mjedis bashkëkohorë dhe gjithëpërfshirs duke i ofruar të rinjve të shprehin talentin dhe krijimtarinë e tyre. Misioni ynë është të krijojmë standarde të reja për komunikimin dhe marketing për Shqipërinë dhe më gjërë.*

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. *Universiteti Barleti:*
 - a. Barleti angazhohet në ofrimin e ambjeteve për trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
 - b. Barleti angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
 - c. Barleti angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut BoldCrest, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
 - d. Barleti shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave të Universitetit për përmbushjen e misionit dhe vizionit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standartet më të mira në nivel europian;
 - e. Personi i kontaktit do të jetë: PhD. Saimir Kristo. Zv. Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative.
2. *BoldCrest:*
 - a. BoldCrest angazhohet në ofrimin e ambjenteve të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Barletit;
 - b. BoldCrest angazhohet në ofrimin e mundësive të punësimit për studentët më të mirë në përputhje me strategjitë e brendshme të zhvillimit të subjektit;
 - c. BoldCrest angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;



- d. BoldCrest angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - e. BoldCrest angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut Barleti, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm;
 - f. Personi i kontaktit do të jetë: Z. Aldo Hako
3. *Palët bashkarisht bien dakort si vijon:*
- a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit;
 - b. të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, çon detyrimisht në prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.
3. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale me të njejtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Barleti dhe 2 (dy) BoldCrest. Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Universiteti "Barleti"
Rektor

Prof. Dr. Suzana Guxholli



BoldCrest

Aldo Hako



BOLD-UP / Intern Program

HYRJE

Po kërkojmë studentë ambiciozë, të talentuar dhe me dëshirën maksimale për të fituar eksperiencë në fushën e marketing. Nëse je kreativ dhe pëlqen një punë dinamike, ku chdo ditë është ndryshe: kjo thirrje është për ty! Kërkojmë karaktere të ndryshme, me një sens humori dhe me dëshirën për tu zhvilluar dhe për të mësuar me projekte të vërteta të industrisë. Mendohu mirë përpara se të aplikosh, pasi ky rrugëtim do të jetë intensiv.

Nëse po kërkon një punë 8 me 5, mund tui rekomandojmë disa kompani të tjera..

SPECIFIKIME MBI PROJEKTIN

- Kohëzgjatja 3 muaj.
- Angazhimi ditor: 3-4 orë
- Çdo praktikant do të ketë një mentor të vetin në departamentin ku po aplikon.
- Mundësi për të punuar në projekte reale.
- Rekomandime dhe mundësi punësimi për ata që performojnë shkëlqyeshëm.

SI APLIKOHET?

- Dërgo një CV, letër interesimi, portfolio, video prezantuese ose një email me disa specifikime rreth vetes në adresën info@boldcrest.com Ka rëndësi që një nga elementët e mësipërm të të diferencoj nga të tjerët.
- Subjekti i email-it duhet të jetë: INTERN APPLICATION - DEPARTAMENTI - EMËR MBIEMËR
- Aplikimet janë të hapura deri më 15 Maj.

ACCOUNT MANAGER INTERN

- Krijimi dhe Menaxhimi i një portofolio të klientëve dhe monitorimi i aktiviteteve të vazhdueshme në lidhje me to.

- Ndjekje dhe asistim gjatë realizimit të projekteve mbi marketingun dhe prezantimi i tyre tek klientët.
- Asistim në detyrat e përditshme të Account Manager.
- Të bëj kërkime për ide të reja dhe të asistoj në bërjen e planeve të punës.

DIGITAL MARKETING INTERN

- Detyrat të përgjithshme administrative si: përgatitja e emaileve, fotokopje, kontrolli i artikujve të inventarit.
- Asistencë në drejtimin e përditshëm të departamentit digjital.
- Analiza e tendencave të marketingut dhe markave të fundit.
- Krijimi i story-ve tërheqëse dhe interaktive.
- Asistencë në administrimin dhe koordinimin e Departamentit Digital.
- Asistencë për të koordinuar axhendat ndërmjet departamenteve.
- Asistencë në bërjen e raporteve mujore.
- Krijimi i planeve për Social Media.

PHOTOGRAPHY INTERN

- Të asistoj në sete fotografike.
- Të bëj kërkime dhe të ndërtoj moodboard për setet e ardhshme.
- Të bëj kërkime për industrinë në të cilat operon agjensia dhe të sjelli ide të reja.
- Të asistoj në skenografi.
- Të asistoj në kompozime të seteve fotografike.
- Të ketë njohuri në arts and crafts.

DESIGN INTERN

- Të zhvilloj kërkime për ide të reja në lidhje me projektet aktuale.
- Të zhvilloj projekte sipas direktivave të mentorit.
- Të ndërtoj portfolio për projektet e agjensisë.
- Të asistoj në bërjen e prezantimeve sipas kërkesave dhe direktivave të mentorit.
- Të asistoj në përgatitjen e materialeve për rrjete sociale si postime etj.

WEBMASTER INTERN

- Të zhvilloj kërkime për ide të reja në lidhje me projektet aktuale.
- Të bwj ndryshime nw faqet egzistuese tw klientwve.
- Të ndërtoj strukturat bazë dhe design tw faqeve.
- Të asistoj webmaster në punët e përditshme.